



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada-Government

*Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe Teknologjisë- Ministarstvo Obrazovanja Nauke i
Tehnologije-Ministry of Education Science and Technology*

Kabineti i Ministrit/Kabinet Ministra/ Cabinet of the Minister

UDHËZIM ADMINISTRATIV

Implementimi i ECTS në Arsimin e Lartë në Kosovë

NUMËR:14/2008

DATË:02.07.2008

Në bazë të kapitullit VI ,neneve 93(4)dhe 97(2)të Kushtetutës së republikës së Kosovës dhe të nenit 4 të Ligjit mbi Arsimin e Lartë në Kosovë i shpallur me rregulloren e UNMIK-ut nr. 2003/14, Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë nxjerr këtë Udhëzim Administrativ:

Neni 1

Qëllimi i Udhëzimit administrativ

Me këtë udhëzim administrativ rregullohet implementimi i Sistemit Evropian të Transferit të Kredive (ECTS) si dhe përcaktohet qasja unike në të gjitha Institucionet e Arsimit të Lartë (IAL) në Republikën e Kosovës për ECTS.

Neni 2

Qëllimi i ECTS

1. ECTS është sistem për transfer dhe akumulim të kredive i cili është i orientuar kah studenti dhe paraqet ngarkesën e studentit për të arritur objektivat e një programi të caktuar të studimit. Objektivat duhet të specifikohen përmes rezultateve të pritura të të nxënit dhe kompetencave që duhet zhvilluar.
2. Ky sistem lehtëson njohjen e periudhës së studimit në institucionet tjera (në vend dhe jashtë), transferin e kredive të akumuluar nga një IAL në tjetrin dhe kështu mundëson mobilitet më të madh të studentëve në Evropë dhe më gjërë.
3. ECTS mundëson që programet e studimit të jenë lehtësisht të lexueshme dhe të

krahasueshme dhe i ndihmon IAL të hartojnë dhe t'i rishikojnë programet e tyre të studimit.

Neni 3

Cikli i studimeve

1. Programi i studimit duhet të përpilohet ashtu që një vit i studimit të ketë 60 kredi (30 kredi për semestër). Secila lëndë duhet të vlerësohet me numër të caktuar të kredive.
2. Në ciklin e parë të studimeve (Bachelor) duhet të akumulohen 180-240 kredi.
3. Në ciklin e dytë të studimeve (Master) duhet të akumulohen 60-120 kredi, ashtu që në fund të ciklit të dytë i diplomuari të ketë mbledhur të paktën 300 kredi.
4. Në ciklin e tretë të studimeve (studimet e Doktoratës) duhet të akumulohen 180 kredi.
5. Kohëzgjatja e programeve të veçanta të studimeve (mjekësia, farmacia, veterina etj.) duhet të përputhet me direktivat e Komisionit Evropian në lidhje me ato programe.
6. Meqenëse një viti akademik i përgjigjet ngarkesa prej 1200-1500 orë pune të studentit, atëherë 1 ECTS pikë kredi paraqet ngarkesën prej 20 deri 30 orë punë.

Neni 4

Implementimi i ECTS nga IAL

1. Çdo IAL duhet që në statutin e vet të përfshij tërë sistemin e ECTS.
2. Të gjitha institucionet e AL në Kosovë duhet të sigurojnë implementimin e plotë të ECTS.
3. Implementimi i ECTS në IAL duhet të bazohet (ose të jetë në harmoni) me “Udhëzuesin për përdorimin e ECTS”, që është dokument kyq për implementimin e ECTS në Europë.
4. Çdo IAL duhet të ketë Koordinatorin institucional për ECTS dhe Koordinatorët për secilën njësi akademike.
5. IAL janë të obliguara që ti njohin dhe pranojnë kreditë e fituara në një IAL tjetër të akredituar.
6. Studenti i fiton kreditë vetëm pasi t'i ketë përfunduar të gjitha obligimet e parapara të një programi dhe ti ketë arritur rezultatet e pritura të të nxënit.
7. Mënyrën e përlllogaritjes së numrit të kredive për lëndët e caktuara të programit të studimeve e cakton IAL, duke u bazuar në Udhëzuesin e lartpërmendur të Komisionit Evropian.
8. Institucionet e AL duhet të lëshojnë transkriptin e notave të shënuara sipas sistemit të brendshëm të vlerësimit duke i shëndërruar njëkohësisht në ekuivalentin sipas vlerës në ECTS.

Neni 5

Dokumentet e ECTS

1. Çdo IAL duhet të përpiloj Pakon informative për ECTS (të dhënat për IAL, programet e studimeve, përshkrimin e lëndëve dhe numrin e kredive dhe të dhënat mbi afatet e provimeve dhe mënyrat e vlerësimit).
2. Çdo IAL duhet të përdorë këto dokumente standarde të ECTS:
 - a) Formën standarde të aplikimit të studentit për mobilitet,
 - b) Marrëveshjen e mësimit,
 - c) Transkriptin e notave, dhe
 - d) Aktet tjera të nevojshme.

Neni 6

Zbatimi i këtij dokumenti

1. IAL janë të obliguara që t'i përmbahen rregulloreve të Agjencia e Akreditimit të Kosovës (AAK) në lidhje me dokumentet e nevojshme për ECTS.
2. IAL duhet të hartojnë dhe dorëzojnë raporte në MASHT lidhur me zbatimin e ECTS, me rastin e vlerësimeve të ndryshme, akreditimit apo licencimit të veprimtarisë.

Neni 7

Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.


Enver Hoxhaj ,ministër